



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2014  
Nr. ref.:RK663/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI212/13**

Parashtrues

**Svetlana Stefanović**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
kërkesës për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese,  
KO108/13, të 9 shtatorit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Svetlana Stefanović (në tekstin e mëtejme: parashtruesja), nga fshati Korminjan i Epërm, komuna e Kamenicës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja nuk konteston ndonjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa individuale e parashtrueses për sqarim të Aktgjykimit (KO108/13) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të 9 shtatorit 2013, lidhur me atë se i njëjti a është i aplikueshëm në gjithë territorin e Republikës së Kosovës apo në mënyrë të pjesshme.
4. Parashtruesja nuk përmend nenet e Kushtetutës që pretendon se i janë cenuar.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 19 nëntor 2013, parashtruesja ka parashtruar kërkesën e saj në Gjykatë.
7. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI212/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI212/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 15 prill 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi asaj që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 25 prill 2014, parashtruesja e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
10. Më 12 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 31 maj 2012, Gjykata Komunale në Kamenicë, përmes Aktgjykimit P. nr. 191/2008 dënoi parashtruesen me dënim me kusht dhe me gjobë për shkak të kryerjes së veprës penale të shmangies nga tatimi sipas nenit 249, paragrafit 1, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës.
12. Më 24 shtator 2013, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë u bë i plotfuqishëm.

13. Në një datë të panjohur për Gjykatën, Gjykata Themelore në Gjilan lëshoi propozimin për ekzekutim (Nr. Vepr. Edgj. 366/2013) të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë (P. nr. 191/2008, të 31 majit 2012).
14. Më 8 nëntor 2013, parashtruesja parashtroi kërkesë për dhënien e amnistisë të Gjykatës Themelore në Gjilan. Parashtruesja nuk ka dorëzuar ndonjë dokument shtesë apo informatë që tregon për statusin e kërkesës së saj për amnisti.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesja në kërkesën e saj pretendon se gëzon të drejtën për të përfituar sipas Ligjit për Amnisti [Ligji nr. 04/L/2009] dhe se edhe në rastin e saj duhet të zbatohet ky ligj.
16. Parashtruesja nuk kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (P. nr. 191/2008, të 31 majit 2012) e as të Gjykatës së Apelit, të cilin e përmend në kërkesë por nuk e ka dorëzuar në Gjykatë.
17. Parashtruesja arsyeton kërkesën e saj për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese (KO108/13, të 9 shtatorit 2013) duke pohuar se: *“Përkundër faktit se kjo veprë penale është në Ligjin për Amnisti në praktikë interpretohen në mënyra të ndryshme nga gjyqtarët dhe prokurorët, aktgjykimi i gjykatës së juaj (...) edhe pse i njëjti është i qartë, se Ligji për Amnistinë zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa kurrfar dallimesh”.*
18. Parashtruesja i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

*“Të bëhet interpretimi – skjarimi i Aktgjykimit të juaj Nr. KO108/13 i datës 9.09.2013 të dhënë lidhur me ligjin për Amnistinë. A aplikohet i njëjti në territorin e tërë Republikës, apo në mënyrë parçiale.*

*[...]*

*Kërkoj që të bëhet interpretimi i pjesës së aktgjykimit (...) i cili ka të bëjë me veprën penale Thirrja në Rezistencë (neni 411) e radhitur në aktgjykimin e përmendur nën 1.1.15, me qëndrimin e juaj nën pikën 193, sipas veprës Thirrja në Rezistencë (neni 319), sipas qëndrimit të juaj nën pikën 236 dhe sipas veprës penale, Nxitja në Rezistencë (neni 186) me qëndrimin e juaj nën pikën 263, me qëllim të mënjanimit të dilemave gjatë zbatimit të Ligjit për Amnistinë në praktikë. Edhe pse në aktgjykimin e përmendur nën pikën 193 keni dhënë qëndrimin e juaj të qartë”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

19. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
20. Gjykata duhet në mënyrë specifike të përcaktojë nëse parashtruesja i ka plotësuar kërkesat e nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.1 të Ligjit dhe rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës.

21. Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.  
[...]*

*“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

22. Neni 47.1 i Ligjit parasheh:

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.*

23. Për më tepër, rregulli 36 (3) c) i Rregullores së punës përcakton se:

*“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:  
c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar”.*

24. Siç është thënë më lart, ajo çfarë parashtruesja kërkon është sqarimi i Aktgjykimit (KI108/13, të 9 shtatorit 2013) të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me atë se a është i njëjti i aplikueshëm në gjithë territorin e Republikës së Kosovës apo vetëm pjesërisht.

25. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se parashtruesja nuk ka ngritur ndonjë pretendim për shkelje të kryer nga autoritetet publike. Në fakt, parashtruesja shprehimisht thekson se *“nuk kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë”* së vendimit të marrë nga Gjykata e Apelit të cilin nuk e ka dorëzuar në Gjykatë dhe nuk e ka kontestuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit (P. nr. 191/2008, të 31 majit 2012) i cili tashmë ka marrë formën e prerë.

26. Gjykata më tutje vëren se parashtruesja nuk siguron informata në lidhje me ndonjë procedurë ose veprim ligjor në lidhje me ankesat e saj.

27. Sa i përket të drejtës së parashtrueses për të parashtruar kërkesë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesja nuk artikulon ndonjë të drejtë apo dhe liri individuale që mund të jetë shkelur dhe as që i referohet ndonjë veprimi apo vendimi konkret të një autoriteti publik që mund të ketë cenuar të drejtat e saj themelore.

28. Në këto rrethana, Gjykata gjen se parashtruesja, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës në lidhje me rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës, nuk është palë e autorizuar për të kërkuar sqarimin ose interpretimin e vendimit të Gjykatës.

29. Rrjedhimisht, për arsyet e cekura më lart, Gjykata gjen se parashtruesja nuk është palë e autorizuar dhe se në pajtim me rregullin 36 (3) c) kërkesa duhet hedhur poshtë si e papranueshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 36 (3) c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani